



OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT

DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

- Drejtuar:** BOE - “Flena RB” sh.p.k., me NIPT K31404040G
Adresa: Rr. “Sulejman Pasha”, pallati i ri 9 katësh, kati përdhe, pranë shkollës “Sinan Tafai”, Tiranë.
- “Myrto Security” sh.p.k., me NIPT K23323401N
Adresë: Në hyrje të Rr. Dibrës, pallatet 9-katëshe, Tiranë.
- “Ro.Gat Security” sh.p.k., me NIPT K11613005V
Adresa: Tiranë, Njesia Bashkiake Nr. 7, Rruga e Kavajes, Pallati 100 Vitrinat, Ngjitur me Shkallen Nr. 18.
- “Vrana Security Group” sh.p.k., me NIPT K52214509N
Adresë: Lagja nr.4, Rr. Egnatia, Pallati 4 katesh, Kati 2, përball “Flegship Center” Durrës.
- “Vaso Security” sh.p.k., me NIPT K23711001K
Adresa: Lagjja 3, Rruga Gavril Pepo, Vila Nr.1, Korçë.

Procedura e prokurimit: E hapur, mbi kufirin e lartë monetar – me mjete elektronike – Shërbime, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik, ku të gjithë kushtet janë të përcaktuara.

Numri i procedurës/referenca: REF-25665-04-19-2022

➤ **Referenca e Lotit II:** REF-25669-04-19-2022

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Loti II: Shërbimi privat i sigurisë fizike për një periudhë 3 vjeçare, për N/Stacionin Tirana 1, N/Stacionin Tirana 2, N/Stacionin Sharrë, N/Stacionin Rrashbull, NJMT, Zyrat Qëndrore OST sh.a., N/Stacionin Elbasan 1, N/Stacionin Elbasan 2, Magazina Elbasan, N/Stacionin Zemblak, N/Stacionin Fier, N/Stacionin Babiçë dhe Magazina Kuçovë.”

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Data 26.04.2022, Nr. 53.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në çmim.

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këtë vlera përkatëse të ofruara:

1. **OE “Aulona-Pol-1” sh.p.k.,** me NIPT K26307202E
Vlera 291,593,631 (dyqind e nëntëdhjetë e një milion e pesëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e tridhjetë e një) Lekë pa TVSH.
2. **BOE “Flena RB” sh.p.k.,** me NIPT K31404040G
“Myrto Security” sh.p.k., me NIPT K23323401N
“Ro.Gat Security” sh.p.k., me NIPT K11613005V
“Vrana Security Group” sh.p.k., me NIPT K52214509N
“Vaso Security” sh.p.k., me NIPT K23711001K
Vlera 296,944,780.68 (dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e dyzet e katër mijë e shtatëqind e tetëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e tetë) Lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit është skualifikuar Ofertuesi i mëposhtëm:

OE “Aulona-Pol-1” sh.p.k., me NIPT K26307202E, për arsye se:

- Nuk ka plotësuar në mënyrë të duhur “Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit”, pasi në disa pjesë të formularit, nuk ka paraqitur të dhënat e referencave ku sigurohen dokumentet e kërkuara në këtë formular. Plotësimi i këtyre të dhënave i jep mundësinë AK për të kryer verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga ofertuesi.
- Nuk ka përmbushur pikën 1/b të Shtojcës 8.2 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi sigurimi i ofertës nuk është bërë në vlerën e kërkuara nga AK, por në një vlerë më të vogël.
- Nuk ka përmbushur pikën 2.2.1 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi xhiroja e kërkuar nga AK në të paktën një vit financiar është kërkuar 300,000,000 (treqind milion) Lekë dhe është shënuar “*Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.*” ndërkohë nga në vërtetimin e paraqitur nga OE, rezulton se kjo vlerë nuk është mundësuar në asnjë nga tre vitet e fundit financiare.
- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.3 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi vërtetimet e paraqitura nga Drejtoritë Vendore të Policisë së Qarqeve duhet të jenë të lëshuara jo më vonë se 30 ditë nga dita e hapjes së ofertave (datë 20.05.2022), ndërkohë që vërtetimet e lëshuara janë respektivisht 21.02.2022, 03.03.2022, 28.02.2022, 03.03.2022, 04.03.2022 dhe 08.03.2022.
- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.7 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur vërtetime përformance dhe nëse ska masa administrative për vitet 2019, 2020 dhe 2021.
- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.8 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur analizën e kostos për ofertën e paraqitur.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë e **BOE “Flena RB” sh.p.k.**, me NIPT K31404040G Adresa: Rr. “Sulejman Pasha”, pallati i ri 9 katësh, kati përdhe, pranë shkollës “Sinan Tafai”, Tiranë & **“Myrto Security” sh.p.k.**, me NIPT K23323401N Adresë: Në hyrje të Rr. Dibrës, pallatet 9-katëshe, Tiranë & **“Ro.Gat Security” sh.p.k.**, me NIPT K11613005V Adresa: Tiranë, Njesia Bashkiake Nr. 7, Rruga e Kavajes, Pallati 100 Vitrinat, Ngjitur me Shkallen Nr. 18 & **“Vrana Security Group” sh.p.k.**, me NIPT K52214509N Adresë: Lagja nr.4, Rr. Egnatia, Pallati 4 katesh, Kati 2, përball “Flegship Center” Durrës & **“Vaso Security” sh.p.k.**, me NIPT K23711001K, Adresa: Lagjja 3, Rruga Gavril Pepo, Vila Nr.1, Korçë, me ofertë ekonomike 296,944,780.68 (dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e dyzet e katër mijë e shtatëqind e tetëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e tetë) Lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”.

ADMINISTRATORI I OST SH.A.

Skerdi Drenova